

## **Znj. Benida Kraja**

Benida Kraja ka lindur në Tiranë, në vitin 1990. Që prej shtatorit 2023 mban pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Zhvillimit të Projekteve, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Në vitin 2015, është diplomuar me master shkencor në “Arkitekturë”, pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, Tiranë, si dhe në 2018 ka kryer një master shkencor në “Arkitekturë Inxhinierike” në Universitetin Politeknik të Milanos. Gjithashtu po ndjek studimet për doktoraturë në “Universita degli studi della Campania Luigi Vanvitelli”.

Më herët i është besuar detyra si Këshilltar Ministri, në Ministrinë e Kulturës, si dhe detyra të tjera si Përgjegjës Sektori në Sekretarinë Teknike dhe Arkitekt Restaurator në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Prej vitit 2019 është Pedagoge e Jashtme në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, dhe pjesë e e projekteve kërkimore shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.